



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E ZËVENDËSKRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN E
KOALICIONIT TË VËZHguesVE VENDORË ME TEMË “KORRUPSIONI
ZGJEDHOR: NEVOJA PËR REFORMË ZGJEDHORE TË THELLË DHE
GJITHËPËRFSHIRËSE”**

26 janar 2016

- Qytetarët shqiptarë, si dhe vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë, kanë shprehur vazhdimisht shqetësimin e tyre rreth praktikave zgjedhore korruptive në Shqipëri. Përgjatë viteve, raportet e OSBE/ODIHR-it kanë theksuar se vijon të ketë pretendime për blerjen e votës; se kuadri ligjor nuk ofron transparencë të mjaftueshme rreth fondeve të fushatës; se ndaj punonjësve të sektorit publik ushtrohet presion për të marrë pjesë në fushata, apo për të votuar në një mënyrë të caktuar; se ka nevojë të rritet paanshmëria e komisioneve zgjedhore; se ndikimi politik pengon pavarësinë redaksionale të mediave dhe se për gratë kandidatë ka shumë pak mbulim mediatik. Disa prej këtyre praktikave janë të padrejta; disa të tjera janë thjesht korruptive. Me vetëm një pikë dyshimi në zgjedhje vihen në dyshim të tëra zgjedhjet dhe vihet në dyshim vetë demokracia. Ka ardhur koha për të trajtuar këto shqetësime përmes procesit të reformës zgjedhore.
- Prezenca e OSBE-së përshëndet krijimin e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore nga Kuvendi muajin e kaluar, dhe pret që ai të fillojë punë shumë shpejt. Komisioni duhet të vendosë përparësi në punën e tij për të luftuar korrupsionin zgjedhor.
- Legjislacioni shqiptar tashmë i ka kthyer disa praktika zgjedhore korruptive në vepra penale, por fjala kyçe mbetet *zbatimi*. Ligji të bëhet i zbatueshëm, pa përjashtime. Nëse në Shqipëri do të zbatoheshin të gjitha ligjet, Shqipëria do të ishte një lloj parajse. Ligji pa zbatim është mashtrim. Ligji pa zbatim është i kotë.
- Autoritetet shtetërore dhe partitë politike kanë rol kyç në luftën kundër korrupsionit zgjedhor. Gjithashtu, roli i shoqërisë civile është i domosdoshëm. Shfrytëzoj rastin që të përgëzoi organizatorët e kësaj konference, Koalicionin e Vëzhguesve Vendorë, për përpjekjet e tyre për të rritur ndërgjegjësimin për këtë çështje dhe për t'u kërkuar llogari institucioneve, partive politike dhe individëve.
- Prezenca e OSBE-së dhe OSBE/ODIHR-i do të vazhdojnë të ndihmojnë institucionet shqiptare përgjatë procesit të reformës zgjedhore.
- Është përgjegjësia dhe nderi ynë që të jemi të lidhur pashmangshmërisht me zgjedhjet. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka një lidhje të fortë e të gjatë me Kuvendin dhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Do të ishim krenarë nëse kemi kontribuar në arritjet e KQZ-së vitin e shkuar, përfshirë rregulloren e brendshme dhe disa përmirësime në mirëfunksionimin e zgjedhjeve dhe pjesëmarrjen më të gjerë partiake në KQZ. Me ODIHR-in ne kemi qendrën më të njohur botërore për ekspertizë në institucionet demokratike dhe zgjedhjet. Natyrisht, ne si OSBE dhe ODIHR-i kemi pranuar ftesën e institucioneve të Shqipërisë që OSBE-ja të mbështesë reformën dhe ju premtoj se kur

institucionet janë gati dhe të sinqerta ekspertiza dhe mbështetja e OSBE-së dhe ODIHR-it do të jenë të palodhura.

- Nevoja për një reformë tërësore, gjithëpërfshirëse dhe të shpejtë është e padiskutueshme. Demokracia juaj ose shërohet ose vdes këtu.
- Pjesëmarrja e sotme është një shenjë e rrallë dhe e shkëlqyer e vullnetit të përbashkët, të përkushtimit për diçka mbi politikën partiake. Autoritetet, institucionet dhe shoqëria civile e qytetarët shqiptarë duhet që më në fund të bashkohen për të siguruar që të ketë votim, numërim dhe raportim të ndershëm. Kjo është baza e pazëvendësueshme e demokracisë dhe legjitimitetit të pushtetit.